



Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura për projektet e vitit 2014

*Vijon në faqen 2*

## VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2013

*Vijon në faqen 3*

## ZHVILLIME TË TJERA

Seminar mbi standardet profesionale të konfidencialitetit (10 dhjetor, Vjenë, Austri)

*Vijon në faqen 5*

## LAJMET NGA RAJONI

EIOPA publikon udhëzimet për trajtimin e ankesave nga ndërmjetësuesit e sigurimeve

*Vijon në faqen 6*

Bosnje – Hercegovina

*Vijon në faqen 7*

Bullgari

*Vijon në faqen 7*

Mali i Zi

*Vijon në faqen 8*

Qipro

*Vijon në faqen 8*

Rumani

*Vijon në faqen 9*

## Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare takohet me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura për projektet e vitit 2014

*Kryetarja e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 23 dhjetor një takim përmbyllës me përfaqësues të tregjeve të mbikëqyrura nga AMF, tregut të sigurimeve, fondeve të pensioneve private vullnetare, letrave me vlerë dhe fondeve të investimeve. Në takim merrnin pjesë edhe anëtarët e Bordit të AMF-së. Gjatë takimit znj. Shehi bëri një pasqyrë të realizimeve të këtij viti dhe problematikave të hasura. Kryetarja e AMF-së prezantoi gjithashtu edhe mesazhet më të rëndësishme për sfidat që presin AMF-në dhe tregun në vitin 2014.*

*Më poshtë është fjala e plotë e Kryetares së AMF-së, znj. Enkeleda Shehi, në takimin përmbyllës.*

Tregu në vitin 2013 ka patur zhvillime pozitive në drejtim të zgjerimit të veprimtarisë së operatorëve në treg, ashtu edhe zhvillime negative, që krijuan mjaft vështirësi për ju dhe për vetë AMF-në. Sikurse jeni në dijeni, në gjysmën e dytë të vitit ne kemi qenë në kontakt të vazhdueshëm dhe kemi zhvilluar diskutime intensive me grupin e përbashkët të Bankës Botërore dhe të Fondit Monetar Ndërkombëtar për programin e vlerësimit të sektorit financiar. Në përfundim të këtyre diskutimeve qeverisë shqiptare, si dhe autoriteteve rregullatore financiare u janë lënë një sërë detyrash dhe rekomandimesh, të cilat në fakt përbëjnë një **strategji afatmesme për stabilizimin dhe zhvillimin e tregut financiar**. Këto detyra e rekomandime do të fillojnë të zbatohen me rigorozitet e intensitet vitin e ardhshëm. Pra, *viti 2014 për të gjithë ne do të jetë i vështirë dhe do të kërkojë shumë punë e ndoshta edhe sakrifica.*

Kërkohet të **përmirësohet funksionimi i tregut të sigurimeve**. Do të bëhen një sërë ndryshimesh në kuadrin rregullator e do të merren një sërë masash për të vendosur standarde të mirëpërcaktuara në lidhje me rezervat minimale, likuiditetin, zbatimin e mbikëqyrjes me bazë rreziku. Gjithashtu kërkohet të merren masa me ndikim afatgjatë, të tilla si zhvillimi i programeve për sigurimin e përgjegjesisë së shërbimeve të ndryshme apo të risqeve nga ngjarjet e natyrës së katastrofave. Në këtë aspekt ne mirëpresim propozimet nga shoqëritë e sigurimit për të paraqitur skema për produkte të reja sigurimi dhe zbatimin e efektshëm të tyre.

Në fushën e **letrave me vlerë** përsëri **theksi vihet në nevojën e zhvillimit të tregut** të kapitaleve. Ne kemi përgatitur me asistencë teknike një dokument për zhvillimin e tregut. Do të mirëprisnim nga operatorët e këtij tregu, në veçanti nga Bursa e Tiranës, propozime për përmirësimin e tij, sepse synohet që tregu sekondar i letrave me vlerë të qeverisë të bëhet më aktiv dhe të rritet roli i Bursës në këtë segment të tregut.

Zhvillimi i tregut të kapitaleve është një objektivi, i cili harmonizohet dhe do t'i shërbejë një tjetër objektivi madhor të Shqipërisë, **reformës së**

Gjatë takimit znj. Shehi bëri një pasqyrë të realizimeve të këtij viti dhe problematikave të hasura. Kryetarja e AMF-së prezantoi gjithashtu edhe mesazhet më të rëndësishme për sfidat që presin AMF-në dhe tregun në vitin 2014.

**pensioneve.** Në këtë kuadër do të nxitet zhvillimi i shtyllës së tretë, dhe si hap i parë ne po kërkojmë riaktivizimin e lehtësisë fiskale për kontributin në fondet e pensioneve private vullnetare. Ndërkohë, nga ana e qeverisë shqiptare do të punohet për reformimin e shtyllës së parë dhe krijimin e shtyllës së dytë, të cilat do ta bëjnë më aktiv tregun e pensioneve në vend. Paralelisht me këtë, edhe metoda e mbikëqyrjes së fondeve të pensioneve do të zhvendoset drejt mbikëqyrjes me bazë rrisht.

Objektivi i zhvillimit të tregut të kapitaleve harmonizohet dhe i shërben edhe objektivit të rritjes së diversifikimit të portofoleve të fondeve të investimit dhe menaxhimit më të mirë të risqeve. Nga fondet e investimeve kërkohet që të kenë një vëmendje më të madhe ndaj likuiditetit dhe menaxhimit të tij, si dhe vlerësimit të portofoleve të tyre për të njohur e menaxhuar më mirë risqet që shoqërojnë investimet. Në gjysmën e parë të vitit 2014 do të bëhen ndërhyrjet e nevojshme në rregulloret që lidhen me likuiditetin, vlerësimin kontabël dhe mjaftueshmërinë e kapitalit për t'i përputhur ato me Direktivat e BE-së.

Në përfundim, por jo më pak e rëndësishmja, të gjithë operatorët në tregjet financiare të sigurimeve, të letrave me vlerë dhe të pensioneve duhet të rritin shkallën e transparencës me klientët e tyre. **Mbrojtja e konsumatorit** është një ndër shtyllat e procesit të stabilizimit dhe nga Autoriteti do të mbikëqyreni në vijimësi për përmbushjen e standardeve ndërkombëtare për raportimin në publik dhe transparencën me konsumatorin.

## VËSHTRIM MBI TREGJET

### Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-nëntor 2013

Tregu i sigurimeve u ul me 5.10% në periudhën janar-nëntor 2013. Vlera e primeve të shkruara bruto në periudhën janar-nëntor 2013 arriti në 7.62 miliardë lekë, ndërsa numri i policave të sigurimit pati një ulje prej 5.40% dhe arriti në 899,048 polica sigurimi.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një ulje prej 2.48% në krahasim me janar-nëntor 2012. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 1.93 miliardë lekë, apo 80.65% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

#### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u ul me 6.67% gjatë periudhës janar-nëntor 2013, krahasuar kjo me të njëjtën periudhë e një viti më parë.

#### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 3.35 miliardë lekë gjatë periudhës janar-nëntor 2013, duke shënuar një ulje prej 17.46% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Znj. Shehi theksoi se të gjithë operatorët në tregjet financiare të sigurimeve, të letrave me vlerë dhe të pensioneve duhet të rritin shkallën e transparencës me klientët e tyre.

Gjatë periudhës janar-nëntor 2013, sigurimi i Jetës u rrit me 9.89% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 44% të tregut të sigurimeve të Jo-Jetës.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- *zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 27.39% të tregut të Jo-Jetës;*
- *sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 12.57% të tregut të Jo-Jetës.*

### Sigurimi i Jetës

Gjatë periudhës janar-nëntor 2013, sigurimi i Jetës u rrit me 9.89% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2012. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” dhe përbën 64.38% të sigurimit të Jetës.

### Ndarja e tregut të sigurimeve, janar - nëntor 2013

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.



## ZHVILLIME TË TJERA

### Seminar mbi standardet profesionale të konfidencialitetit

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Fondeve të Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*) në bashkëpunim me Autoritetin e Tregjeve Financiare të Austrisë (*Austrian Financial Market Authority, FMA*) organizuan seminarin rajonal me temë “Detyrimet e standardit profesional të konfidencialitetit” (*Professional Secrecy Equivalence*). Seminari u zhvillua më 10 dhjetor 2013, në Vjenë,

Austri me pjesëmarrjen e ekspertëve në fushën e sigurimeve nga rajoni i Evropës Juglindore.

Seminari synonte forcimin e bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve të vendeve anëtare dhe jo anëtare të BE-së. Ky bashkëpunim është thelbësor për një mbikëqyrje efektive të grupeve të sigurimit dhe aktiviteteve të tjera ndërkufitare. EIOPA ka iniciuar punën për vlerësimin e ekuivalencës së regjimeve të konfidencialitetit profesional. Në seminar u bë edhe një pasqyrë e legjislacionit aktual dhe përpjekjeve për rregullimet e ardhshme të BE-së në lidhje me konfidencialitetin profesional në fushën e sigurimeve.

Fokusi i vlerësimit do të shtrihet në katër drejtime kryesore, të cilat janë:

- Sekretet profesional;
- Mbikëqyrja e risigurimeve;
- Llogaritja e aftësisë pagueuse në nivel grupi;
- Mbikëqyrja e grupeve.

Gjatë vitit 2014, EIOPA do të iniciojë procedurat e vlerësimit me vendet e interesuara, për të vijuar më tej me firmosjet e marrëveshjeve me rregullatorët e vendeve anëtare të BE-së.

Seminari synonte forcimin e bashkëpunimit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit midis autoriteteve mbikëqyrëse të sektorit të sigurimeve të vendeve anëtare dhe jo anëtare të BE-së.

## LAJMET NGA RAJONI

### **EIOPA publikon udhëzimet për trajtimin e ankesave nga ndërmjetësuesit e sigurimeve**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority EIOPA*) ka publikuar udhëzimet për trajtimin e ankesave nga ndërmjetësuesit e sigurimeve. Udhëzuesi vendos drejtimit kryesore për sistemet e brendshme dhe kontrollin sa më të përshtatshëm të trajtimit të ankesave, sigurimin e informacionit dhe procedurat për t'ju përgjigjur ankesave. Udhëzimet, të cilat caktojnë parimet e nivelit të lartë për autoritetet kompetente kombëtare, janë plotësuar nga një raport lidhur me praktikën më të mira të mbikëqyrjes. Autoritetet kompetente kombëtare duhet të sigurojnë që ndërmjetësit e sigurimit:

- Të vendosin një politikë të menaxhimit të ankesave, e cila u mundëson atyre për të hetuar ankesat në mënyrë të drejtë;
- Të vënë në dispozicion politikën e menaxhimit të ankesave tek i gjithë stafit përkatës;



Udhëzuesi vendos drejtimit kryesorë për sistemet e brendshme dhe kontrollin sa më të përshtatshëm të trajtimit të ankesave, sigurimin e informacionit dhe procedurat për t'ju përgjigjur ankesave.

- Të kërkojnë të mbledhin dhe hetojnë të gjitha provat dhe informacionin në lidhje me një ankesë;
- Të komunikojnë në gjuhë të thjeshtë e të kuptueshme;
- Të sigurojnë përgjigje pa vonesa të panevojshme.

Objektivi kryesor i këtyre udhëzimeve është të sigurojë që përfitimet për konsumatorët të jenë më të mëdha se kostot për autoritetet kompetente kombëtare dhe ndërmjetësit. EIOPA gjithashtu i kushton vëmendje natyrës dhe madhësisë së ndryshme të ndërmjetësve të sigurimeve në Evropë, të cilët mund të jenë që nga bizneset e vogla e deri tek korporatat e mëdha multinacionale.

Këto udhëzime ndjekin ato të mëparshmet në trajtimin e ankesave nga siguruesit. Të dy grupet e udhëzuesve plotësojnë një “rreth të plotë të mbrojtjes” për konsumatorët. Autoritetet kombëtare kompetente duhet të përputhin kuadrin e tyre rregullator dhe mbikëqyrës me udhëzimet e EIOPA-s duke i përfshirë ato në të.

Gabriel Bernardino, Kryetar EIOPA-s u shpreh se “me këto udhëzime, ne duam të sigurohemi që konsumatorët e BE-së do të marrin mbrojtjen që u duhet dhe kanë të drejtë. Me publikimin e tyre EIOPA po përmbush mandatin në mbrojtje të konsumatorit, pjesëmarrësit më të rrezikuar në treg për shërbimet dhe produktet financiare.”

## **Bosnje - Hercegovina**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në fund të muajit shtator 2013, vlera e përgjithshme e primeve të shkruara bruto nga kompanitë aktive të sigurimit, në të dy njësitë administrative që formojnë Bosnjën dhe Hercegovinën (*Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, FBiH dhe Republika Serbe e Bosnjës, RS*) është rritur me 3.5% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë duke arritur duke arritur në deri në 202 milionë euro.



Sipas shifrave financiare të publikuara nga të dy autoritetet e tregut (*Agjencia e Sigurimit Mbikëqyrës e FBiH - NADOS dhe Agjencia e Sigurimit të RS-AZORS*), 73.7% e totalit të primeve të shkruara bruto janë realizuar nga kompanitë e sigurimeve, të cilat janë të regjistruara në FBiH dhe 27.3% janë regjistruar nga siguruesit e RS.

Duke analizuar shifrat totale për të gjithë tregun e sigurimeve, portofoli i tregut përbëhet nga rreth 17.6% sigurim Jete dhe 82.4% i korrespondon klasave të sigurimit të Jo-Jetës.

## Bullgari

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Zhvillimi i tregut të sigurimit bullgar gjatë nëntëmuajorit të vitit 2013 tregoi të njëjtat tendenca, ashtu si në gjysmën e parë të vitit. Tregu pati një normë të konsiderueshme rritjeje në sigurimin e Jetës dhe një rritje modeste në sigurimin e Jo-Jetës, kjo e nxitur kryesisht nga sigurimi i shëndetit dhe sigurimet në grupin e MTPL-së.



Volumi total i primeve të shkruara bruto arriti në vlerën 629 milion euro, me një rritje prej 8% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Volumi i primeve në sigurimin e Jetës arriti vlerën 115.5 milion euro, ose 22.5% me shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërsa në sigurimet e Jo-Jetës, primet e shkruara bruto arritën në 513 milion euro, me një rritje nga viti në vit prej 5%.

Sigurimit motorik tregoi një normë rritjeje prej 3.6%. Kjo më shumë falë rritjes prej 8.6% të primeve të MTPL-së, gjë e cila kompensoi rënien prej 2.3% të primeve të shkruara bruto të sigurimit motorik Kasko.

Bazuar në reformat e fundit, sigurimi i shëndetit pati performancën e dytë më të mirë në terma absolute, me një shtesë të primit të shkruar bruto prej 14 milion euro krahasuar me tremujorin e tretë të vitit të kaluar. Nga klasat e sigurimeve të përgjithshme, 10.5% të primeve e zë sigurimi i pronës me 21.3 milion euro dhe 60% e zënë sigurimet motorike ekuivalente me 121 milionë euro.

## Mali i Zi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave paraprake të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi, gjatë periudhës janar-shtator 2013, tregu i sigurimeve në vend arriti vlerën e 53.6 milion euro ose 4.9% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Struktura e primit të shkruar bruto përbëhet nga 86.4% sigurimi i Jo-Jetës dhe pjesa tjetër prej 13.6% i takon sigurimit të Jetës.

Siç është vënë re edhe në periudhat e mëparshme, segmenti i Jo-Jetës është dominuar nga sigurimi motorik që zuri 54% të tregut në total, dhe brenda tij pjesën më të madhe e zë sigurimi i detyrueshëm, TPL e brendshme, e cila zuri 47%.

Tregu bullgar pati një normë të konsiderueshme rritjeje në sigurimin e Jetës dhe një rritje modeste në sigurimin e Jo-Jetës, kjo e nxitur kryesisht nga sigurimi i shëndetit dhe sigurimet në grupin e MTPL-së.

Tregu i sigurimeve në Malin e Zi arriti vlerën e 53.6 milion euro ose 4.9% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Janë gjithsej njëmbëdhjetë kompani sigurimi që kryejnë veprimtarinë në tregun e sigurimeve të Malit të Zi, gjashtë kompani sigurimi kryejnë vetëm veprimtarinë e sigurimit të Jetës dhe pesë kompani kryejnë aktivitetin e Jo-Jetës.

## Qipro

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Industria e sigurimeve në Qipro, edhe pse e vogël dhe e prekur nga kriza financiare, ra me 5.6% duke arritur në 577 milion euro gjatë nëntëmujorin e vitit 2013.

Industria e sigurimeve në Qipro, edhe pse e vogël dhe e prekur nga kriza financiare, ra me 5.6% duke arritur në 577 milion euro gjatë nëntëmujorin e vitit 2013. Shifrat u deklaruan në raportin e Shoqatës së Sigurimeve të Qipros. Në klasat kryesore të sigurimit, rënie më të madhe të primeve të shkruara bruto e pësuan klasat e sigurimit të Jetës me 9% më pak, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa segmenti i Jo-Jetës është ulur me 2.9% o krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Totali i dëmeve të paguara ishte rreth 490 milionë euro, nga të cilat 322 milion euro janë për policat e sigurimit të Jetës. Në sigurimet e Jo-Jetës, shumica e dëmeve të paguara bruto lidhet me sigurimet motorike, me rreth 89 milionë euro dëme të paguara.

## Rumani

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu rumun i sigurimeve regjistroi një rritje të lehtë gjatë nëntëmujorit të këtij viti me një vlerë të primit të shkruar bruto me 1.42 miliardë euro.

Tregu rumun i sigurimeve regjistroi një rritje të lehtë gjatë nëntëmujorit të këtij viti me një vlerë të primit të shkruar bruto me 1.42 miliardë euro. Primi i shkruar bruto në sigurimet e Jo-Jetës u rrit me 1.5%, ndërsa primi i shkruar bruto në sigurimet e Jetës ra me 1.2%.



Primet e shkruara bruto për grupet e “Anuiteteve dhe sigurimit plotësues” shënuan një rënie pothuajse 3% duke e çuar volumin e përgjithshëm të primit bruto në sigurimin e Jetës në 283.5 milion euro.

Në sigurimet e Jo-Jetës, tendencën udhëheqëse erdhi nga segmenti i sigurimit MTPL primet e të cilit u rritën me 14.5%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ose rreth 53 milionë euro. Sigurimi MTPL arriti 29% të tregut, dhe ishte grupi me vlerën më të lartë midis të gjitha grupeve të biznesit.

Prirja në rënie e regjistruar nga sigurimi Kasko vazhdoi gjatë nëntë muajve



të këtij viti, duke rezultuar në një vëllim prej 310 milionë euro prime të shkruar bruto. Kjo shifër ishte 25 milionë euro më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi Kasko zuri vetëm 22% të tregut në fund të shtatorit të vitit 2013.

**Për këtë numër punuan:**

*R. Guri, D. Kalaja, P. Berberi, R. Eltari, E. Beqir-Aga  
Dh. Hazbiu, E. Kokona*

